



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 15 maj 2014
Nr.ref.:RK622/14

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI07/14

Parashtrues

Lulzim Gosalci dhe Gjylymsere Ferataj

**Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Supreme të Kosovës, PML. nr. 231/2013, të 24 dhjetorit 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë z. Lulzim Gosalci dhe znj. Gjylymsere Ferataj nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, PML nr. 231/2013, të 24 dhjetorit 2013, të cilin parashtruesit e kërkesës e kanë pranuar më 10 janar 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML nr. 231/2013, me të cilin ishte refuzuar kërkesa e parashtruesve për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitura kundër Aktvendimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Kp. nr. 429/2013, të 20 shtatorit 2013 me të cilin parashtruesit kishin kërkuar që Gjykata Supreme të aprovojë kërkesën e tyre dhe që të anulojë aktgjykimin e atakuar në mënyrë që parashtruesit *“të lirohen nga aktakuza në kuptim të nenit 364 të KPPK-së”*.

Baza juridike

4. Neni 113.7 lidhur me nenin 21.4 të Kushtetutës, neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, dhe rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Procedura në Gjykatë

5. Më 20 janar 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.
6. Më 31 janar 2014, me Vendimin Nr. GJR. KIo7/14, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues) Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.
7. Më 10 shkurt 2014, Gjykata Kushtetuese njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 14 mars 2014 Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 11 dhjetor 2009, Gjykata Komunale në Prishtinë nxori Aktgjykimin P. nr. 562/2008, me të cilin parashtruesit e kërkesës i shpalli fajtorë dhe i gjykoi: parashtruesin e parë për kryerjen e veprës penale shkelja e urdhrave për masat e fshehura ose teknike të vëzhgimit ose hetimit nga neni 172 par. 2 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), duke ia shqiptuar dënimin me burg prej tetë (8) muajve dhe parashtruesin e dytë për veprën penale zbulimi i fshehtësisë zyrtare nga neni 347 par 1 i KPK-së, me dënim me burg prej gjashtë (6) muajve, dënime të cilat nuk do t'i mbanin nëse në afat prej një (1) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk do të kryenin vepër të re penale.

10. Kundër këtij aktgjykimi, ankesa kanë parashtruar edhe përfaqësuesi ligjor i parashtruesve, edhe prokurori publik për shkaqet e cekura në ankesat e tyre.
11. Më 15 nëntor 2011, Gjykata e Qarkut në Prishtinë ka nxjerrë Aktvendimin Ap. nr. 87/2010, me të cilin ankesat e përfaqësuesit të parashtruesve dhe të prokurorit publik i ka hedhur poshtë si të palejueshme për shkak se sipas arsytimit të aktvendimit në përputhje me nenin 400 par. 1 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), personat e autorizuar për ankim janë të detyruar ta paralajmërojnë ankimin, gjë që sipas Gjykatës së Qarkut, në rastin konkret nuk e kanë bërë, andaj ankesa është e palejueshme.
12. Më 12 prill 2012, parashtruesit e kërkesës kanë bërë kërkesë për rishikimin e procedurës penale në Gjykatën Komunale në Prishtinë duke kërkuar rishikimin e aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe të aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, duke pretenduar se këto vendime gjyqësore janë të përshtuara me *“shkelje të ligjit penal”* dhe janë shkelur *“dispozitat e procedurës penale”*.
13. Më 20 shtator 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë ka nxjerrë Aktvendimin Kp. nr. 429/13, me të cilin i refuzoi si të pabaza kërkesat për rishikimin e procedurës penale të parashtruesve të kërkesës, e përfunduar me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, P. nr. 562/2008, të 11 dhjetorit 2009.
14. Në arsyetimin e këtij aktvendimi, në mes të tjerash thuhet se: *“Nga shikimi në shkresat e lëndës dhe nga gjurmimi gjegjësisht referenca e gjyqtarit Vesel Ismaili për shqyrtimin e fakteve të paraqitura në kërkesë rezulton se pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor është bërë një pauzë e pastaj palët prokurori dhe të dënuarit janë ftuar në zyrë ku është shpallur aktgjykimi dhe në pika të shkurtra janë dhënë arsyet me ç’rast palët dhe mbrojtësit e tyre janë deklaruar të kënaqur me aktgjykim. Nga procesverbali i seancës kryesore dt. 11.12.2009 shihet se nuk ka fare konstatim se palët pas shpalljes së aktgjykimit kanë paralajmëruar ankesë”*.
15. Më 18 tetor 2013, parashtruesit kanë paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore, me të cilin iu refuzua rishikimi i procedurës.
16. Më 21 nëntor 2013, Gjykata e Apelit nxori Aktvendimin Pn. nr. 703/2013, me të cilin refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesve dhe e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Kp. nr. 429/13, të 20 shtatorit 2013, me të cilin ishte refuzuar kërkesa për rishikimin e procedurës penale.
17. Në arsyetimin e këtij aktvendimi, Gjykata e Apelit kishte theksuar: *“Me qenë se kërkesa për rishikimin e procedurës penale e as ankesa e ushtruar kundër aktvendimit mbi refuzimin e kërkesës, të dënuarve nuk përmban prova nga neni 432 par. 1 nënparagrafi 1.1 deri në 1.5 të KPP-së kolegji i kësaj gjykate duke u bazuar në këtë gjendje faktike, Propozimin e Prokurorisë së Apelit, vlerësoi se gjykata e shkallës së parë drejt ka vepruar me rastin e refuzimit të kërkesës së të dënuarve pasi që nuk ekzistojnë shkaqe ligjore për rishikimin e procedurës e të cilin qëndrim e pranon edhe kjo gjykatë”*

18. Të pakënaqur me këtë aktvendim, parashtruesit kanë paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës.
19. Më 24 dhjetor 2013, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin Pml. nr. 231/2013, me të cilin i refuzoi si të pabazuara kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtruesve të paraqitura kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Kp. nr. 49/2013, të 20 shtatorit 2013.

Pretendimet e parashtruesit

20. Parashtruesit e kërkesës nuk kanë specifikuar drejtpërdrejt shkelje të ndonjë dipozite kushtetuese, por kanë theksuar se *”pasi kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të parashikuara me ligj ju janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës duke kërkuar të drejtën themelore që mbrohet nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës për mbrojtje të barabartë të të drejtave përpara gjykatave”*, ata gjithashtu kanë theksuar se *“vendimi mbi dënimin nuk i është bërë i njohur gjatë seancës por i’u është dërguar me shkrim dhe në këtë mënyrë janë privuar nga e drejta e përdorimit të mjeteve juridike”*.

Pranueshmëria e kërkesës

21. Për të qenë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtruesit, Gjykata paraprakisht vlerëson nëse pala i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara me Kushtetutë, Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e punës.
22. Lidhur me këtë, i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, ku përcaktohet:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

23. Gjykata konsideron se, duke i marrë parasysh këto dispozita ligjore, parashtruesi është palë e autorizuar, se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj dhe e ka dorëzuar kërkesën në afatin e paraparë ligjor.
24. Megjithatë, Gjykata gjithashtu duhet të marrë parasysh nenin 48 të Ligjit, i cili parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar (...)”.

25. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu i referohet nenit 36, i cili parasheh:

“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

[...]

(c) kërkesa është qartazi e bazuar”.

(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...],

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;

[...], ose

(d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

26. Në të vërtetë, Gjykata vëren se parashtruesit kontestojnë aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë që refuzoi ankesën e tyre si të palejueshme për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe vendimit mbi sanksionin penal dhe tani, ata kontestojnë aktgjykimin e Gjykatës Supreme, duke pretenduar se ai shkel të drejtën e tyre të garantuar për “proces të rregullt ligjor dhe mbrojtjen gjyqësore të të drejtave”.
27. Gjykata rikujton se, në pajtim me parimin e subsidiaritetit, parashtruesit e kërkesës duhet të ngrejné shkeljen e pretenduar kushtetuese qysh në gjykatat e rregullta, ashtu që në radhë të parë të sigurojë respektimin e të drejtave themelore të mishëruara në Kushtetutë.
28. Gjykata vëren se në rastin konkret, përpos pretendimeve për shkelje procedurale, parashtruesit nuk janë ankuar për shkelje të të drejtave të njeriut në cilëndo fazë të procedurës penale para gjykatave të rregullta dhe tani kërkojnë nga gjykata kushtetuese të konstatojë shkelje mbi çështje që për bazë kanë aplikimin e drejtë të ligjshmërisë apo të konstatimit të gjendjes faktike, e që nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese.
29. Ndërkohë, Gjykata përkujton se Gjykata e Qarkut e kishte refuzuar ankesën e parashtruesve, sepse kishte konstatuar se është e palejueshme për shkakun se sipas KPPK-së, “personat e autorizuar për ankim janë të detyruar ta paralajmërojnë ankimin “ dhe këtë detyrim ligjor parashtruesit nuk e kishin përmbushur dhe po këtë qëndrim juridik e kanë mbajtur edhe të gjitha vendimet pasuese gjyqësore deri te Gjykata Supreme, kur kanë shqyrtuar ankesat e parashtruesve lidhur me këtë rast. Sidoqoftë, parashtruesit nuk sqarojnë saktësisht pse dhe si vendimi i tillë ua kishe shkelur atyre të drejtën e gjykimin të drejtë dhe të paanshëm dhe mbrojtjen gjyqësore të të drejtave.
30. Për më tepër, Gjykata konsideron se aktvendimi i Gjykatës së Qarkut, si dhe aktgjykimi i Gjykatës Supreme kanë dhënë arsyetim të gjerë dhe të plotë të fakteve të çështjes dhe sidomos ndaj pretendimit kryesor për mosshpallje të vendimit mbi dënimin kur kanë konstatuar se “se pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor është bërë një pauzë e pastaj palët, prokurori dhe të dënuarit janë ftuar në zyrë ku është shpallur aktgjykimi dhe në pika të shkurta janë dhënë arsyet me ç’rast palët dhe mbrojtësit e tyre janë deklaruar të kënaqur me aktgjykim”.
31. Gjykata më tej thekson se konstatimet ligjore janë të arsyetuara mirë dhe të qarta në përgjigjen ndaj pretendimit të paraqitur nga parashtruesit e kërkesës. Prandaj, Gjykata konstaton se procedurat në gjykatat e rregullta kanë qenë të

drejta në tërësi (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

32. Në lidhje me këtë, Gjykata rithekson që nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, që të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta që t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës, Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, para. 28, shih gjithashtu rastin Nr. KI70/11, parashtrues Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima, Aktvendimi për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
33. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në atë mënyrë që procedurat në përgjithësi dhe të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtruesi i kësaj kërkesë ka pasur gjykim të drejtë (shih, ndër të tjera, Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejta të Njeriut, i 10 korrikut 1991).
34. Si përmbledhje, Gjykata nuk mund të gjejë argumente dhe dëshmi se Aktgjykimi i kontestuar, PML. nr. 231/2013, i 24 dhjetorit 2013, i Gjykatës Supreme të Kosovës, është nxjerrë në mënyrë qartazi të padrejtë dhe arbitrare.
35. Prandaj, Gjykata konkludon se parashtruesit nuk e kanë mbështetur pretendimin e tyre dhe as nuk kanë paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tyre të garantuara me Kushtetutë, KEDNJ dhe protokollat e tij ose me Deklaratën Universale për të Drejta të Njeriut.
36. Në këto rrethana, kërkesa, në mbështetje të rregullit 36. 1. b) dhe d), është qartazi e pabazuar dhe si e tillë e papranueshme.


PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të nenit 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe të rregullit 56 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese, më 14 mars 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u kumtohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese



Arta Rama-Hajrizi



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani